Universiteti Aleksander Moisiu

Fakulteti i Biznesit

Departamenti i Makretingut

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE JSTOR

FUSHA E APLIKIMIT**:** **Ekonomi Publike.**

Tema: **Investimet publike në infrastrukturë si faktor zhvillimi ekonomik, Rasti i Shqipërisë.**

Punoi: Brian Shahini

Master Shkencor në Menaxhim-Marketing Viti II

Durrës, 2021

Abstrakti

Investimet publike në infrastrukturë dhe ndikimi i tyre në ekonomi kanë qenë në qendër të studimeve dhe analizave akademiko-politike. Shumë kërikime kanë synuar të arrjinë në një konkluzion konkret mbi ndikimin e tyre në rritjen ekonomike, por ende ka paqartësi mbi impaktin e tyre real. Shumë studiues argumentojnë se investimet infrastrukturore kanë ndikim direkt mbi zhvillimin ekonomik, ndërsa të tjerë shtrojnë idenë se investimet infrastrukturore ndikojnë në mënyrë indirekte dhe me një efekt minimalist në ekonomi. Rëndësia dhe qëllimi i këtij studimi qëndron në evidentimin e ndikimit të investimeve publike infrastrukturore në ekonomi. Ky studim analizon rolin e tyre dhe shqyrton të dhënat makroekonomike të Shqipërisë në 10 vitet e fundit duke përjashtuar vitin 2020 si shkak i bllokoimit të investimeve dhe uljes ekonomike si pasojë e pandemisë Covid-19. Shifrat statistikore kanë vërtetuar një ndikim të vogël të investimeve infrastrukturore në rritjen ekonomike. Kjo si shkak i cilësisë së ulët të investimeve duke u pasuar me një mungesë efiçence dhe produktiviteti nga ana e tyre. Thellimi në këtë çeshtje do të sjell një qartësim të ideve mbi ndikimin e investimeve publike infrastrukturore në ekonomi.

Fjalët *kyçe*: investime publike infrastrukturore, zhvillim ekonomik, partneritet publik-privat, produktivitet.

Hyrje

Një ekonomi e mirë ndikon në mënyrë pozitive në zhvillimin e çdo sektori të një vendi. Çdo politikë hartohet për të pasur një ekonomi të qëndrueshme, pasi kjo qëndrueshmëri do të sillte dhe zhvillim ekonomik. Por, a mund të kemi një stabilitet ekonomik nëqoftëse kemi vendime politike të gabuara? Shqipëria vjen nga një e shkuar diktatoriale, me mungesë te dukshme përsa i përket tregut të lirë, funksionimit të shtetit ligjor dhe konceptit bazë të lirisë. Një periudhë tranzitore 30 vjeçare, një luftë e përditshme për të konsoliduar lirinë, funksionimin e shtetit ligjor dhe tregut (Kolsti, 1985).Shumë analiza dhe raporte ekonomike janë bërë për të dhënë një panoramikë të gjendjes në të cilën Shqipëria ndodhet. Ajo konsiderohet si një vend kyç përsa i përket pozicionit gjeografik dhe burimeve natyrore që zotëron (Zavalani & Durham,1944). Një evidentim i potencialeve të Shqipërisë është bërë nga ana e BE dhe SHBA, duke sjellë rekomandime dhe programe zhvillimi nga ana e tyre. Po ashtu evidentohen edhe mungesa të theksuara përsa i përket infrastrukturës, nivel të ulët arsimor dhe nivel të lartë varfërie. Raporte mbi infrastrukurën e transportit në Shqipëri nxjerrin në pah një cilësi të ulët dhe një pamjaftueshmëri në përmbushjen e nevojave të një vendi (Holzner et al., 2006). Gjithashtu, investimet në sektorin e energjitikës dhe ujësjellësit kërkojnë investime konkrete për të arritur cilësinë e duhur. Për më tepër vërehet një mungesë e investimeve në infrastrukturën arsimore dhe shëndetësore, por problemi që parashtrohet është: -Të investohet më shumë në infrastrukturë rrugore, energjitike, arsimore apo shëndetësore? Gjithsesi zhvillimi infrastrukturor është prioriteti i çdo qeverie(Imran & Niazi, 2011). Për zhvillimin infrastrukturor dhe për rritjen e eficencës infrastrukturore qeveritë promovojnë partneritetin publik-privat. Që pas krizës

së viteve 2008 u rrit interesi për burime alternative të financimit privat. Qeveritë për të mbajtur investimet në nivele të njëjta, tërheqin investitorë përmes formave të ndryshme të partneritetit. Po ashtu operimi në treg i PPP ka sjellë problematika që duhen rregulluar me anë të ligji (Asllani, 2009).

Eficenca e investimeve publike në infrastrukturë ka qenë preh e shumë polemikave. Infrastruktura krijon një ambient të favorshëm për sektorin privat, duke krijuar një klimë të përshtatshme që firmat prodhuese të zhvillojnë aktivitetin e tyre ekonomik (Buddhadeb&Prabir,1998) Gjithashtu, efekti social i investimeve infrastrukturore varet shumë nga eficenca e tyre. Por, a ekziston një lidhje midis investimeve publike në infrastrukturë dhe rritjes ekonomike?

Zhvillimi i aktivitetit ekonomik presupozohet që të ketë një lidhje të drejtpërdrejt me investimet publike. Shumë vende të pazhvilluara shpeshherë nënvizojnë faktin që infrastruktura e dobët është pengesa kryesore për rritjen afatgjatë të ekonomisë. Gjithashtu, ështe vënë re një impakt pozitiv edhe në ekonomitë në zhvillim (Latif; 2002). Por nga ana tjeter në vendet e zhvilluara duket se impakti është i vogël ose në disa raste i papërfillshëm.

METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur në këtë studim është e natyrës cilësore dhe sasiore. Shqyrimi i literaturës fokusohet në analizimin e investimeve publike infrastrukturore dhe ndikimi që ato kanë në ekonomi. Gjithashtu kërkimit kërkon Të analizojë të dhëna sekondare si statistika, shifra dhe raporte, nga FMN, Ministria e Financave, INSTAT etj, me qëllim arritjen e konkluzioneve mbi ndikimin real të investimeve infrastrukturore në ekonominë Shqipëtare.

Qëllimi i studimit

Ky studim ka për qëllim pasqyrimin e ndikimit të investimeve infrastrukturore në ekonomi. Duke analiziar të dhënat makroekonomike të republikës së Shqipërisë dhe literaturën

teorike synohet të arrihet në përfundime konkrete. Modelet teorike shpesh paraqesin se ndikimi investimeve infrastrukturore në ekonomi është i dobët si pasojë e pa aftësisë së qeverive për të kryer investime eficente. Studimi ynë konsiston në qartësimin e kesaj ideje duke analizuar investimet infrastrukturore në Republiken e Shqipërisë.

Roli i qeverisë në investimet publike infrastrukturore

Ekonomia dhe tregu i lirë është faktori kryesor i zhvillimit ekonomik, për të incentivuar sipërmarrjen e lirë dhe luftën kundër monopolit. Vitet e fundit ka pasur shumë diskutime përsa i përket këndvështrimeve ekonomike në raport me rolin e shtetit në procesin e zhvillimit. Në fakt është bërë e paevitueshme nevoja për kufizimin e aktivitetit shtetëror, roli i tij duhet të ulet në mënyrë të tillë që të krijojë një mjedis favorizues për zhvillimin e sektorit privat (Bruyn, 1995). Më konkretisht, ndërhyrja shtetërore në ekonomi duhet të zhvillohet me shumë kujdes, në mënyrë që të sjellë favorizim të sektorit privat dhe jo frenimin e tij. Por, në rastin kur shteti është prezent në mënyrë të tepërt në investime dhe aksione, tregohet një mungesë e lirisë së tregut dhe politikave incentivuese. Mos incentivimi i tregut të lirë sjell mosfunksionime të sektorit privat dhe dhe mbështetja do të ndihmonte në mirëfunksionimin e ekonomisë (Lim, 1983). Qeveria duhet të arrijë të kordinojë ekonominë sipas ligjeve të vëna në zbatim, të cilat duhet të korespondojnë me funksionimin adeguat të kërkuar nga grupet e interesit. Objektivi parësor i çdo qeverie është :funksionimi i ligjit, Incentivimi i sektorëve që gjenerojnë më shumë të ardhura, Favorizimi ligjor i tregut vendas, mbështetja e konsumatoreve për të arritur evitimin e abuzuesve.(Tobin,1964) Gjithashtu nëse qeveria ndërmer investime ato duhet të përbëhen nga disa komponentë si: qartësia në qëllim, pavarësia, llogaridhënia, transparenca, parashikueshmëria dhe jo-diskriminimi. Gjithashtu dhe sigurimi cilësisë së punimeve

infrastrukturore është kritike për zhvillimin infrastrukturor të një shteti. Një administratë që përdor fondet e akorduara në menyrë eficente rrjedhimisht sjellë investime infrastrukturore me një cilësi të lartë, pasuar me eficencë të investimit infrastrukturor.

Evidentimi shpenzimeve publike infrastrukturore në republikën e Shqipërisë

Në tabelen nr. 1 paraqitet ecuria e investimeve kapitale dhe rritja ekonomike[1] vjetore në %. Në shqyrtim merret periudha 2009-2019 duke perjashtuar vitin 2020 si pasoje e bllokimit total të ekonomisë dhe investimeve prej situatës së pandemisë Covid-19.



Tabela 1. Burimi: Ministria e financave

Si edhe shikohet fondet e vëna ne dispozicion për investime kapitale në disa vite pësojnë rënie në krahasim me vitet pararendëse, dhe kjo gjë ka ardhur për shkak të rishqyrtimeve të buxheteve vjetore.[2] Kjo gjë ka ndodhur si pasojë e nevojës për të mbajtur në kontroll defiçitin buxhetor dhe në raste të tjera si pasojë e mungeses së financimit për shkak të

[1] Albania investment council. (Korrik, 2019). Një kendveshtrim mbi treguesit e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë. https://www.investment.com.al/albania-economic-outlook/
[2] Ministria e financave. Projekt buxhetet ndër vite. https://www.financa.gov.al/projektbuxhet/

problematikave me prokurimet publike[3] ku gjatë vitit 2020 dhe periudhës së parë të vitit 2021 rezulton se në periudhën në fjalë janë asistuar 936 procedura të publikuara në SPE nga këto institucione. Ndër to 70 % e procedurave kanë rezultuar problematike në hartimin e kritereve. Apo mosrealizimit në kohë te punimeve, sidomos në projekte infrastrukturore



të mëdha. **Shpenzimet kapitale** të vitit 2018 paraqesin një realizim në masën rreth 57.5 miliardë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, ky zë është 12 përqind më i lartë.[4]

Tabela 2. Burimi : Instat, 2018.

Si dhe shikohet në tabelen nr. 2 nivelin më të lartë të investimeve për vitin 2018 e mban Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me rreth 50% të totalit të investimeve ose 42.8 miliard lek. Gjë që tregon qartazi infrastruktura thith pjesën më të madhe të investimeve. Por këto investime sjellin rritje ekonomike? Në tabelen nr. 3 paraqiten të dhënat në përqindje mbi realizueshmërinë e projekteve buxhetore të planifikuara.[5]

[3] Kryeministria. (2021). https://kryeministria.al/newsroom/paketa-e-re-ligjore-per-prokurimin-publik/
[4] Ministria e financave. (2018). https://www.financa.gov.al/treguesit-fiskale-te-11-mujorit-2018-te-ardhurat-rriten-me-17-miliarde-leke-krahasuar-me-nje-vit-me-pare-investimet-12-me-te-larta/
[5] Ministria e Financave. https://www.financa.gov.al/ecuria-e-investimit-te-projekteve-2/



Tabela 3. Burimi: Ministria financave

Evidentohet që shpenzimet me realizueshmeri më të medha janë për mbrojtje, mirëqënie, shëndetësi. Përsa i përket transportit shikohet një mungesë e realizueshmerisë, gjë qe sjell rritje kostosh në një moment të dytë për buxhetin e shtetit (Singh, 2010). Ndërsa sa i përket energjisë kemi një realizueshmeri më të lartë krahasuar me transportin.

Ndryshimet e treguesve makroekonomikë të republikës së Shqipërisë si pasojë e investimeve publike

Për shkak të rëndësisë qëllimi parësor i investimeve publike është perkthimi i tyre në rritje ekonomike (Cashin, 1995) Si edhe shikihet nga tabela nr.4 trrendi i rritjes ekonomike dhe investimeve publike përgjithësisht kanë ecuri të ngjashme.



Tabela 4. Burimi: Ministria e Financave

Aty ku kemi rritje të lartë ekonomike kemi investimet më të medha dhe anasjelltas. Norma mesatare e rritjes ekonomike rezulton 3,6% dhe investimet publike mesatarisht 5% e PBB-së. Në këtë rast mund të themi që investimet publike në Shqipëri janë përkthyer në rritje ekonomike edhe pse rritja ekonomike në raport me PBB-në nuk ka qënë në nivele të larta.

Në tablën nr.5 paraqitet grafiku i ecurisë se investimeve publike me rritjes së PBB-së.



Tabela 5. Burimi:M F, Instat.

Si dhe vërehet më sipër kemi një ulje të nivelit të rritje të PBB si pasojë e krizëz botërore të viti 2008. Gjithashtu shohim një tendencë rritëse përkhrah me investimet publike, duke treguar një korrelacion midis investimeve publike dhe rritjes së PBB-së. Dukeqenë se ekziston një ndikim i drejtperdrejte i nivelit të investimeve mbi rritjen e PBB-së (Veld,2017).

Vlersimi i eficences së investimeve infrastrukturore në Shqipëri.

Zhvillimi infrastrukturor i Shqipërisë është një nga prioritetet primare të çdo qeverie, dhe synimi është krijimi i kushteve me qëllim zhvillimin e çdo sektori të ekonomisë (Somik, 1999).Teoria ekonomike tregon se lidhjet midis infrastrukturës dhe zhvillimit ekonomik janë të qarta. Sigurimi i infrastrukturës në nivele te larta në zona lokale duhet të zvogëlojë drejtoerdrejte kostot për aktivitetet prodhuese të cilat cojnë në nxitjen e zhvillimin ekonomik(Diamond & Spence, 1984).

Çdo investim lind si një kërkesë për plotësimin e një nevoje për zhvillim, dhe që ky investim të përkthehet në zhvillim duhet të plotësojë disa kushte. Kushti më përmbledhës është ai që investimi të jetë eficent.Por si ndikon infrastruktura në zhvillimim ekonomik?

Infrastruktura kontribuon në zhvillimin ekonomik, si duke rritur produktivitetin, ashtu edhe duke siguruar asete që rrisin cilësinë e jetës. Shërbimet e krijuara nga investimet në infrastrukturë çojnë në rritjen e prodhimit të firmave (Kesside, 1993).

Një indikator i përdorur në shumë vende për pasqyrimin e gjendjes infrastrukturore është Indeksi i Konkurrueshmërisë Global 2019[6]

Sipas këtij raporti ku vlerësohet infrastruktura e përgjithshme evidentohet dukshëm që Shqipëria ka ende shumë për të bërë jo vetëm për arritjen e standardeve të BE por për të bërë të mundur krahasimin me vendet e rajonit. Ajo pozicionohet në vendin e 96 nga 141 vende të marra në studim.

Infrastruktura e përgjithshme	**Vlerësimi(0-100)**	**Renditja nga 141 vende**
Kroacia	78.2	32
Slovenia	78	33
Greiqa	77.7	37
Serbia	74	51
Rumania	72	55
Bullgaria	71	56
Mali **i** Zi	64	83
Bosnje Hercegovina	63	84
Shqipëria	58	96

Tabela nr 6. Burimi: Raporti i konkurueshmërisë globale 2019

[6] World Economic Forum. (2019). “The Global Competitiveness Report 2019”

https://www.weforum.org/reports/how-to-end-a-decade-of-lost-productivity-growth

Ashtu si edhe evidentohet në tabelat nr.6, nr.7 dhe nr.8 në infrastrukturën e përgjithshme, të transportit si edhe të asaj energjitike-ujore Shqipëria vlerësohet e fundit në rajon. Kjo e gjitha si pasojë e mungesës dhe cilësisë së dobët infrastrukturore. Gjithashtu sipas FMN investimet e bëra në Shqipëri nuk janë eficente prandaj ajo beson se “Shqipëria është pjesë e grupit të vendeve me efikasitetin më të ulët të investimeve ”[7]. Në rastin tonë do të ishte mirë që shteti të kishte një qasje krejt tjeter mbi infrastrukturore kjo lidhur me faktin që investimet infrastrukturore kanë ndikim në periudha afatgjata që variojnë nga 30-40 vite.

Infrastruktura e Trasnportit	**Vlerësimi (0-100)**	**Renditja nga 141 vende**
Kroacia	62.1	36
Greqia	60.6	39
Serbia	58.7	46
Slovenia	58.3	47
Rumania	54.4	61
Bullgaria	51.7	68
Mali i Zi	40.5	106
Bosnje Hercegovina	39.8	108
Shqipëria	**35.5**	**120**

Tabela nr 7. Burimi: Raporti i konkurueshmërisë globale 2019.

[7] Independent Balkan News Agency. (2017). Albania with the poorest quality of infrastructure. https://balkaneu.com/albania-with-the-poorest-quality-of-infrastructure/

Infrastruktura Energjitike -Ujore	Vlerësimi (0-100)	Renditja nga 141 vende
Slovenia	97	14
Greqia	94.7	35
Kroacia	94.4	38
Bullgaria	91	48
Serbia	89	54
Rumania	89	55
Mali i Zi	86.7	66
Bosnje Hercegovina	86.2	67
Shqipëria	**79.9**	**85**

Tabela nr 8. Burimi: Raporti i konkurueshmërisë globale 2019.

Përfundimet

Investimet publike infrastrukturore në Republikën e Shqipërisë kanë qenë në luhatje të vazhdueshme gjatë 10 viteve të fundit. Megjithëse buxheti i investimeve ka qënë i orientuar drejt investimeve infrastrukturore kriza botërore e viti 2008 solli pasoja në rritjen ekonomike dhe rrjedhimisht në sasinë e investimeve publike. Gjithsesi investimet në infrastrukturë janë pasuar me një mungesë realizueshmërie duke mos sjellë konkludimin e tyre me pasojë rritjen e kostove të investimeve.

Studimi ynë shqyrtoj investimet publike në raport me rritjen ekonomike dhe PBB-në. U evidentua që trendi i investimeve publike shkon krah më krah me rritjen ekonomike dhe PBB. Pra rritja e investimeve publike pasohet me rritje ekonomike dhe rrjedhimisht rritje të PBB. Vitet e fundit në Shqipëri kemi rezultuar me një normë mesatare përgjithësisht të ulët, prej 3,6%.

Gjithashtu vlerësimi i efiçencës së investimeve publike infrastrukturore në Republikën e Shqipërisë ka qenë pjesë e studimit. Sipas raportit të publikuar në 2019 nga “Raporti global i konkurencës”, në aspektin infrastrukturor, Shqipëria renditet e fundit në rajon si në infrastrukturën e përgjithshme ashtu në atë të transportit si edhe në atë të energjitikës dhe ujore. Kjo si pasojë e mungesës dhe cilësisë së ulët të investimeve të bëra. Mungesa e eficencës në kosto dhe në kohë kanë bërë që Shqipëria të jetë më pak konkuruese në rajon për tërheqjen e investimeve të huaja.

Rekomandime

Në këtë studim mbi ndikimin e investimeve publike infrastrukturore arritëm të evidentojmë një mori problematikash mbi infrastrukturën në Shqipëri. Shqipëria renditet e fundit në rajon sa i përket infrastrukturës së transportit, energjitikës dhe asaj ujore. Gjithashtu u evidentua që investimet publike infrastrukturore sjellin një rritje ekonomike shumë të ulët në raport me shpenzimet duke rezultuar jo-eficente. Kjo si pasojë e shumë faktorëve si: mungesa e realizueshmërisë ose shtyrjes në kohë të projekteve, cilësia e dobët e investimeve etj. Shqipëria ka një rrugë të gjatë përpara sa i përket investimeve publike në infrastrukturë. Dhe ajo duhet të përmirësohet në disa aspekte si:

1. Rritja e investimeve infrastrukturore

Si edhe sugjeruar nga modelet teorike, në vendet me të ardhura të ulta, si edhe rasti i Shqipërisë, është e rëndësishme që investimet në infrastrukturë të jenë konstante dhe në nivelet e duhura për arritjen dhe garantimin e rritjes ekonomike. Kështu që Shqipëria duhet të rrisë nivelin e investimeve për të arritur një nivel te rritjes ekonomike të kënaqshëm. Gjithashtu rritja e investimeve infrastrukturore pasuar me një rritje ekonomike do të sillte ulje të borxhit publik.

2. Rritja e cilësisë se investimeve infrastrukturore

Lidhur me sasinë e konsiderueshme te parave te investuara në infrastrukturë Shqipëria serish rezulton ndër vendet me infrastrukturën me te dobët. Një rritje në cilësinë e investimeve do të pasohej me një efikasitet më të lartë të tyre, rrjeshimisht me rritje ekonomike.

3. Realizueshmëria e projekteve

Mungesa e realizueshmërisë dhe shtyrja e tyre ne kohë sjell rritje te kostove të investimeve, kështu që ekziston nevoja për rritje të realizueshmërisë për të mbajtur investimet në nivele

eficente. Në rastin e Shqipërisë evidentohen probleme me realizueshmërinë vecanerisht në sektorin e infrastrukturës së transportit.

4. Konkurrueshmëria në raport me vendet e tjera

Shqipëria nën këndveshtrimin e infrastrukturës së përgjitsheme, rrugore dhe atë energjitiko ujore ezulton e fundit në rajon dhe e pozicionuar shumë ulët krahasueshmërisht me vende të zhvilluara ekonomikisht. Që Shqipëria të arrijë të thithë investime të huaja dhe të rrisë ekonominë e sajë ajo duhet të rrisë investimet në cilësi dhe në sasi që të pozicionohet më mirë krahasimisht me vendet e tjera.

Bibliografia

- Albania investment council. (Korrik, 2019). Një kendveshtrim mbi treguesit e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë. https://www.investment.com.al/albania-economic-outlook/
- Asllani, A. (2009). Albania: Public Private Partnership in Albania. European Public Private Partnership Law Review, 4(4), 239–240. https://www.jstor.org/stable/26696249
- Bruyn, S. T. (1995). A New Role for Government in Society: Creating a Social Market. The Newsletter of PEGS, 5(1), 14–16. http://www.jstor.org/stable/20710669
- Buddhadeb Ghosh, & Prabir De. (1998). Role of Infrastructure in Regional Development: A Study over the Plan Period. Economic and Political Weekly, 33(47/48), 3039–3048. http://www.jstor.org/stable/4407415 fq 3039-3047
- Cashin, P. (1995). Government Spending, Taxes, and Economic Growth. Staff Papers (International Monetary Fund), 42(2), 237–269. https://doi.org/10.2307/3867572
- Diamond, D., & Spence, N. (1984). Infrastructure and Regional Development: Theories. Built Environment (1978-), 10(4), 262–269. http://www.jstor.org/stable/23286635
- Holzner, M., Christie, E., & Gligorov, V. (2006). Infrastructural needs and economic development in south-eastern Europe: the case of rail and road transport infrastructure. SEER: Journal for Labour and Social Affairs in Eastern Europe, 9(1), 15–50. http://www.jstor.org/stable/43293142
- Imran, M., & Niazi, J. (2011). Infrastructure and Growth. *The Pakistan Development Review*, *50*(4), 355–364. http://www.jstor.org/stable/23617703
- Independent Balkan News Agency. (2017). Albania with the poorest quality of infrastructure. https://balkaneu.com/albania-with-the-poorest-quality-of-infrastructure/

- Kesside,c.(1993).the contributions of infrastructure to economic development : a review of experience and policy implications . world bank discussion papers ; no. Wdp 213. Washington, d.c. : world bank group
- Kolsti, J. (1985). Albania’s New Beginning. Current History, 84(505), 361–386. http://www.jstor.org/stable/45315569
- Kryeministria. (2021). https://kryeministria.al/newsroom/paketa-e-re-ligjore-per-prokurimin-publik/
- Latif, M. A. (2002). Income, Consumption and Poverty Impact of Infrastructure Development. The Bangladesh Development Studies, 28(3), 1–35. http://www.jstor.org/stable/40795657
- Ministria e Financave. (2018).https://www.financa.gov.al/treguesit-fiskale-te-11-mujorit-2018-te-ardhurat-rriten-me-17-miliarde-leke-krahasuar-me-nje-vit-me-pare-investimet-12-me-te-larta/
- Ministria e Financave. https://www.financa.gov.al/ecuria-e-investimit-te-projekteve-2/
- Ministria e financave. Projekt buxhetet ndër vite. https://www.financa.gov.al/projektbuxhet/
- Norris,E.D. Brumby,J. Kyobe,A. Mills,Z. Papageorgiou,C. (2011). Investing in Public investment: An index of public investment efficency” IMF
- Singh, r. (2010). Delays and cost overruns in infrastructure projects: extent, causes and remedies. Economic and political weekly, 45(21), 43–54. http://www.jstor.org/stable/27807050
- Somik V. Lall. (1999). The Role of Public Infrastructure Investments in Regional Development: Experience of Indian States. Economic and Political Weekly, 34(12), 717–725. http://www.jstor.org/stable/4407765

- Tobin, j. (1964). Economic Growth as an Objective of Government Policy. Cowles Foundation for Research in Economics at Yale University. USA.
- Veld, J. In’t. (2017). A PUBLIC INVESTMENT STIMULUS IN SURPLUS COUNTRIES AND ITS SPILLOVERS IN THE EA. National Institute Economic Review, 239, R53–R62. https://www.jstor.org/stable/48564737
- World Economic Forum. (2019). “The Global Competitiveness Report 2019” https://www.weforum.org/reports/how-to-end-a-decade-of-lost-productivity-growth
- Zavalani, T., & Durham, M. E. (1944). RESOURCES OF ALBANIA. Geography, 29(3), 80–85. http://www.jstor.org/stable/40562385

.